

Prishtinë, 28 janar 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_764\_2016

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 16 paragrafi 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për Lëshimin e Autorizimit V\_569\_2013 të datës 24 tetor 2013 për shoqërinë “Hydro - Line” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, vendi i quajtur Thanishte/Ovqar, komuna e Mitrovicës; dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit V\_569\_2013 të datës 24 tetor 2013, për ndërtimin e kapacitetit të ri gjenerues për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, vendi i quajtur Thanishte/Ovqar, komuna e Mitrovicës, të datë 05.10.2015 të shoqërisë “Hidro Line” sh.p.k., me adresë “Mbretëresha Teutë”, p.n. -Mitrovicë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit V\_569\_2013 i datës 24 tetor 2013, i shoqërisë “Hidro Line” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, vendi i quajtur Thanishte/Ovqar, komuna e Mitrovicës, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **24 tetor 2016**.

## A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 03.05.2013 nga shoqëria “Hydro - Line” sh.p.k., ka pranuar kërkesën/aplikacionin për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bistrica, HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, komuna e Mitrovicës.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria Hidro Line” sh.p.k., ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Uji, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_538\_2013 me datë 28 qershor 2013.




- Vendim mbi njoftimin për autorizimin preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
  - ZRRE me datë 16.10.2013 nga shoqëria “Hydro - Line” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, komuna e Mitrovicës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
  - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, me datë 24 tetor 2013 ka vendosur që shoqërisë “Hidro Line” sh.p.k., ti lëshohet Autorizimi V\_569\_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, komuna e Mitrovicës.
  - ZRRE me datë 05.10.2015 nga shoqëria “Hidro Line” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V\_569\_2013 të datës 24 tetor 2013, për HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, komuna e Mitrovicës, për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.
  - Shoqëria “Hidro Line” sh.p.k.,ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit për Autorizim, dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: *jemi në fazën e përfundimit të projektit, pajisjet elektromekanike janë liferuar nga prodhuesi i kontraktuar dhe tani jemi në montimin e pajisjeve9turbinave gjeneratorëve dhe pajisjeve tjera përcjellëse) brenda centralit.*
  - *Gjithashtu ka sqaruar se arsyeja e parashtrimit të kërkesës për shtyrje është vonesa e realizimit të projektit kanë ardhur si pasojë e ndërtimit të pikës së lidhjes së centralit në rrjetin distributiv nga ana e KEDS, si pasojë është dashur të bëhet riprojektimi i largpërçuesit dhe furnizimit me pajisje tjera për largpërçues si dhe ndërtimin e stabilimenteve të kontraktuara të tensionit të mesëm , brenda ndërtesës së centralit që na është dashur të presim s’paku dhjetë (10) muaj shtesë për prodhimin e tyre. Andaj, duke marr parasysh thëniet e cekura më lartë kanë kërkuar që bazuar në nenin 16 paragrafi 4 i Rregullës për Procedurën e Autorizimit, që tu vazhdohet afati edhe për një (1) vit, në mënyrë që të kompletohet ndërtim i hidrocentralit.*
  - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, të shoqërisë “Hidro Line” sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, për HC Albaniku 3, me kapacitet të instaluar prej 4.267 MW, në lokacionin “Dolac”, ZK Dolac, komuna e Mitrovicës, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim V\_569\_2013 i datës 24 tetor 2013, pas skadimit të afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, mund të shfuqizohet me datë **24 tetor 2016**, në rast se pala nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi
- III. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.





- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Bordi i ZRRE-së:**

  
Enver Halimi, kryesues

  
Krenar Bujupi, anëtar

  
Arsim Janova, anëtar

  
Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar